



REPUBLIKA E SHQIPERISE
PROKURORII PERGJITHSHEM

URDHER

Nr. 184 date 06. 09.2003

PER

CAKTIMIN E RREGULLAVE/PROCEDURËS SË BETIMIT TË PROKURORËVE

Me synim,

- rritjen e përgjegjshmërisë së prokurorëve të të gjithë niveleve, në marrjen përsipër të detyrës, për ushtrimin e funksioneve Kushtetuese dhe ligjore, si dhe;
- caktimin e rregullave për procedurën e betimit të prokurorëve;

Mbështetur, në nenet 8 pika 2, 22 pika 3 e vijues të ligjit Nr. 8737 datë 12. 02. 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë",

U R D H Ë R O J

1. PËRKUFIZIME

1.1. **Betimi i prokurorit** është një **akt solemn dhe ngjarje e shenuar me vlera morale dhe juridike**, për ushtrimin e funksioneve të -tij.

1.2. Në zbatim të kësaj urdhëri, termat e më poshtëm kanë kuptime:

1.2.1 "Betim"- Premtim solemn për të qëndruar besnik, për të kryer detyrën dhe për të vepruar në përputhje me ligjin;

1.2.2 **"Formulë betimi"**- Pohim i shkurtër që përmbledhë në mënyrë të prerë fjalët që përmban ky premtim;

1.2.3 **"Betohe"** - Premtoj në mënyrë solemne për të qëndruar kurdoherë besnik, për të kryer detyrën dhe për të vepruar në përputhje me Kushtetutën, ligjet dhe etikën;

1.2.4 "Procedura e betimit" - Rregullat që ndiqen për të kryer betimin.

2. BETIMI I PROKURORËVE TË TË GJITHË NIVELEVE

2.1. Prokurorët e të gjithë niveleve, në rastet e emërimit në detyrë, para fillimit të punës bëjnë betimin, sipas formulës së betimit që vijon: "**Betohem solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës do t'i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do të ruaj të pastër figurën e prokurorit. Betohem!**"

2.1.1. Prokurorët e sapoemëruar në detyrë, në zbatim të nenit 21 të ligjit, në Prokuroritë pranë Gjykatave të çdo niveli, betohen përpara Prokurorit të Përgjithshëm ose të deleguarit prej tij, si dhe përpara të gjithë prokurorëve të asaj prokurorie.

3. PROCEDURA E BETIMIT SIPAS NIVELEVE TË PROKURORTVE

3.1. Betimi i prokurorëve të sapoemëruar në çdo nivel Prokurorie bëhet në mënyrë ceremoniale, në ambiente të përshtatshme të prokurorëve përkatëse, duke u respektuar këto rregulla:

3.1.1. Prokurori dhe/ose prokurorja që do të bëjë betimin dhe prokurorët e pranishëm vishen me pelerinën e prokurorit të atij niveli.

3.1.2. Në ceremoninë e betimit të prokurorëve, sipas niveleve të Prokurorive, merr pjesë Prokurori i Përgjithshëm ose i deleguari i tij dhe mund të ftohen përfaqësues të Presidencës, të Pushtetit Ekzekutiv, të Pushtetit Gjyqësorë, të profesoriatit dhe media.

3.1.3. Prokurori i Përgjithshëm ose i deleguari i tij, pas pershëndetjeve të rastit, fton pranë tij prokurorin dhe/ose prokuroren që do të bëjë betimin dhe pasi lexon **formulën e betimit**, ai dhe/ose ajo që bënë betimin përsërit fjalën "**Betohem**".

3.2. Në të gjitha rastet, pas kryerjes së betimit, prokurori nënshtruan fletën e betimit, e cila vendoset në dosjen vetjake të tij.

4. ZBATIMI DHE PËRGJEGJËSIA PËR MOSBËRJEN E BETIMIT OSE SHKELJEN E TIJ

4.1. Për të ndjekur e kontrolluar zbatimin e këtij urdhëri ngarkotien Drejtoria e Personelit dhe Inspektimit e kësaj zyre dhe drejtuesit e Prokurorive të të gjithë niveleve.

4.2. Prokurorët e të gjithë niveleve, mund t'i ushtrojnë funksionet e tyre vetëm pas bërjes së betimit.

4.2.1. Mospranimi për të bërë betimin ose shkelja e tij, përbejnë shkelje të rëndë të disiplinës.

4.2.2. Ndaj prokurorëve që kryejnë këtë shkelje të disiplinës, propozohet vetëm masa disiplinore "**shkarkim nga detyra**".

5. HYRJA NE FUQI

- 5.1. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.
- 5.2. Me këtë urdhër të njihen prokurorët e të gjithë niveleve të Prokurorive.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

THEODHORI SOLLAKU